

**STATUTI DHE AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“SKYLINE ENGINEERING”SH.P.K**

**KREU I  
DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**Neni 1:**

**FORMIMI I SHOQERISE**

- a. Sot, më 20 Shkurt 2023 , themelohet shoqeria tregtare me përgjegjësi të kufizur e emertuar

“SKYLINE ENGINEERING”SH.P.K ,me vullnetin e lire te ortakëve ,ne baze te ligjit 9901 datë 14.04.2008 ”Per tregëtaret dhe shoqërите tregtare”. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “SKYLINE ENGINEERING”SH.P.K, formohet nga ortakët themelues :

1) Themeluesi i shoqërisë eshte :

- a) **ARBËR SELIMI**, atësia , Bekë shtetas Shqiptar , identifikuar me anë të Leter njoftim ID me numër 033909212, me numër personal identifikimi **I50706067B** i datëlindjes 06/07/1985 , lindur në Tropojë dhe banues në Tirane me adresë Bulevardi Bajram Curri :Nd.002 Njesia administrative Nr 1 Tiranë 1 ; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- b) Te cilet me vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me Ligjin Nr .9901 date 14.04.2008”Per tregëtaret dhe shoqërите tregtare”, si dhe Aktin e Themelimit ,kane vendosur te destinojne ne kete sipermarrje kapitalin e tyre ,me qellim qe te perfitojne te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria private e shoqerisë ,si dhe të perballojë humbjet deri në kufirin e vlerës se kontributit ne Kapitalin Themeltar

Shoqeria ushtron veprimtarinë e saj ne bazë të ekonomisë së tregut të lirë, Shoqeria tregtare “SKYLINE ENGINEERING”SH.P.K” fiton Personalitet Juridik nga dita e regjistrimit të saj pranë zyrës së Qëndres Kombetare të Biznesit në Tiranë

**FORMA DHE EMERTIMI I SHOQERISE**

**Neni 2:**

1-Shoqeria tregetare ,eshte organizuar si Shoqeri Tregetare me Pergjegjesi te Kufizuar

2.Emertimi i shoqerise eshte : “**SKYLINE ENGINEERING”SH.P.K**”

3.Në rast trasferimi të vepriimtarisë tregtare ,mund të ruhet I njëjtë emërtim ,me kusht që Personi Juridik të shtojë në këtë emërtim një shënim I cili ka të bëjë me trasferimin.

**Neni 3:**

**Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.



**Neni 4:**  
*Selia*

1-Shoqëria "SKYLINE ENGINEERING"SH.P.K", ka selinë qëndrore në territorin e Republikës së Shqipërisë ne qytetin e Tiranës Rruga Muhamed Deliu ,Pallatet Jonaldo ,Ndertesa Nr 4 ,Ap .35 kati 7

2-Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

***OBJEKTI I VEPRIMTARISË***

**Neni 5**

Objekti i shoqërisë "SKYLINE ENGINEERING"SH.P.K", do të jetë

- Hartimi i projekteve ndërtuese
- Shërbime Topografike,plan rilevini,
- Vlerësim pasurish të paluajtshme

***KAPITALI I SHOQËRISË***

**NENI 6**


- 1) Kapitali themeltar filletar i shoqërisë është 10,000(dhjetë mijë) Lekë dhe është i ndarë në 1 (një) kuotë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
  - a) Ortaku themelues i vetëm ARBËR SELIMI zotëruesh i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 10,000(dhjetë mijë) Lekë, që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
  - b) Kapitali filletar nuk është paguar

**Neni 7**  
*Administrimi*

- 1) Administratori i shoqërisë emërohet ARBËR SELIMI , atësia Bekë shtetas Shqiptar , identifikuar me anë Leternjoftim ID me numër 033909212, me numër personal identifikimi **I50706067B** i datëlindjes 06/07/1985, lindur në Tropojë dhe banues në Tiranë, me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emëritimit.

**Neni 8**  
*Kompetencat e Administratorëve*

- 1) Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
  - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;



- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

**Neni 9  
Viti Financiar**

- 1) Viti finanziar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përashtimi, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

**NENI 10**

*Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi, ndarja*

- 1) Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

**Neni 11  
Baza Ligjore**

- 1) Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plete me ketë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

**Neni 12  
Mosmarrëveshjet**

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

**O R T A K U I VETEM  
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"SKYLINE ENGINEERING"SH.P.K**

**ARBËR SELIMI**

*Arber Selimi*

